

Vendim nr. 127 datë 05.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 05.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: DRITA KAPLLANI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1301, datë 26.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-5316, datë 13.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.05.2008 kërkuesja Drita Kapllani (*kërkuesja*) ka udhëtuar me linjën ajrore “Belleair”, me itinerar Piza-Tiranë, dhe ka mbërritur në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”. Po në këtë datë kërkuesja është paraqitur në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar (*SUQU*), ku është diagnostikuar me “*fractura communitive dustale radius dex*”, duke iu rekomanduar “imobilizim me allçi të artikulacionit dhe marrje e mjekimit ambulator”, sipas vërtetimit nr. 6105, datë 22.05.2008 të lëshuar nga ky institucion shëndetësor.

2. Në datën 12.03.2010 kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi kundër shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a. (*Sigal sh.a.*) dhe thirrur si person të tretë shoqërinë “Tirana International Airport” sh.p.k. (*TIA*), duke kërkuar detyrimin e të paditurit për t’i shpërblyer dëmin pasuror dhe jopasuror në vlerën 3 600 000 lekë, dëm i cili, sipas saj, i është shkaktuar nga aksidenti i ndodhur në datën 22.05.2008 në terminalin e aeroportit “Nënë Tereza”, ku për shkak të lagështirës së dyshemesë është rrëzuar duke pësuar dëmtime shëndetësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6396, datë 30.05.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1301, datë 26.05.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5316, datë 13.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses.

3. Në datën 09.04.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.04.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

4. ***Kërkuesja***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

4.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesja dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj. Ajo gjykatë, në kundërshtim me provat, shprehet se kërkuesja nuk ka arritur të provojë se është rrëzuar si pasojë e lagështirës në dyshemenë e aeroportit dhe se ka pësuar dëm. Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen, pasi ka vendosur vetëm për procedurën, duke vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet

e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), megjithëse përmbante shkaqe ligjore sipas shkronjës “a” të kësaj dispozite, pra mosrespektimin ose zbatimin e keq të ligjit nga gjykata e apelit.

4.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i gjykatës së apelit është jo i plotë, i pasaktë dhe kontradiktor.* Në lidhje me përfundimet e saj ajo gjykatë nuk ka analizuar provat e paraqitura nga kërkuesja dhe përse këto prova nuk i merr në konsideratë. Gjykata e apelit nuk legjitimon kërkuesen në ngritjen e padisë, duke u shprehur se nuk është e siguar, ndërkohë që kërkuesja nuk ka ngritur padi me këtë shkak ligjor, por për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, për të cilën gjykata nuk analizon elementet e këtij dëmi dhe përse ato nuk përmbushen në rastin konkret. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe kontradiktor, pasi ka mospërputhje në përmbajtje, si dhe mes përmbajtjes dhe dispozitivit. Ajo gjykatë, nga njëra anë, shprehet se rekursi nuk plotëson kushtet ligjore për t’u marrë në shqyrtim, ndërkohë që, nga ana tjetër, shprehet se gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe material, aspekte këto që i përkasin shqyrtimit të çështjes. Gjykata e Lartë shprehet në terma të përgjithshëm, por nuk analizon aspektet procedurale apo ligjore që kanë të bëjnë me çështjen konkrete, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit të ngritur në rekurs për zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e apelit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve

juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

6. Kriteret e lartpërmendura për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

7. Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin janë marrë vendimet objekt kundërshtimi, për rrjedhojë është bartëse e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara.

8. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 13.12.2023, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në datën 09.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuësja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin e kësaj

Gjykate, ndaj, duke pasur parasysh thelbin e tyre, Kolegji vlerëson t'i analizojë në vijim të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

12. Kërkuesja ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga ajo dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj. Personi i tretë, TIA, nuk ka mohuar asnjëherë aksidentin e ngjarë në ambientet e saj, ndërsa i padituri Sigal sh.a. e ka çuar kërkuesen për diagnostikime të mëtejshme në një klinikë private, ndërkohë që gjykata e apelit, në kundërshtim me provat, shprehet se kërkuesja nuk ka arritur të provojë se është rrëzuar si pasojë e lagështirës në dyshtemenë e aeroportit dhe se ka pësuar dëm. Edhe Gjykata e Lartë, sipas kërkueses, nuk e ka shqyrtuar çështjen, pasi ka vendosur vetëm për procedurën, duke vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, megjithëse rekursi përmbante shkaqe ligjore, sipas shkronjës “a” të kësaj dispozite, pra mosrespektimin ose zbatimin e keq të ligjit nga gjykata e apelit.

13. Po ashtu, kërkuesja ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është jo i plotë, i pasaktë dhe kontradiktor. Sipas saj, gjykata nuk ka analizuar provat e paraqitura edhe përse këto prova nuk i merr në konsideratë. Përveç kësaj, gjykata e apelit e nuk legjitimon atë në ngritjen e padisë, duke u shprehur se nuk është e siguar, megjithëse ajo nuk ka ngritur padi me këtë shkak ligjor, por për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, për të cilën gjykata nuk analizon elementet e këtij dëmi dhe përse ato nuk përmbushen në rastin konkret. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, sipas kërkueses, është i paarsyetuar dhe kontradiktor, pasi ka mospërputhje në përmbajtje, si dhe mes përmbajtjes dhe dispozitivit, ndërsa, nga njëra anë, shprehet se rekursi nuk plotësonte kushtet ligjore për t'u marrë në shqyrtim, ndërkohë që, nga ana tjetër, shprehet se gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe material, aspekte këto që i përkasin shqyrtimit të çështjes. Gjykata e Lartë, sipas saj, shprehet në terma të përgjithshëm, por nuk analizon aspektet procedurale apo ligjore që kanë të bëjnë me çështjen konkrete, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit të ngritur në rekurs për zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e apelit.

14. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Ndërkohë, neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit përbën një aspekt të saj. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar edhe se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 38, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata është shprehur se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar, që garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih*

vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 27, datë 27.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se ajo gjykatë krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e saj të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ndërkohë Gjykata në mënyrë konstante ka theksuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre, nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, referuar praktikës dokumentare të paraqitur nga kërkuuesja, Kolegji vëren se ajo ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor, ku me kërkesëpadinë e paraqitur ka kërkuar detyrimin e të paditurit Sigal sh.a. për t'i shpërblyer dëmin pasuror dhe jopasuror, dëm i cili, sipas saj, i është shkaktuar nga aksidenti i ndodhur në datën 22.05.2008 në terminalin e aeroportit “Nënë Tereza”, në afërsi të sportelit të kontrollit të pasaportave, për shkak të lagështirës së dyshemesë të porsalarë, ku është rrëzuar duke pësuar dëmtime shëndetësore, për të cilat fillimisht i është dhënë ndihmë rastësore, ndërsa më pas punonjësit e aeroportit e kanë dërguar për ndihmë mjekësore të specializuar pranë SUQU-së. Për shkak të dëmtimeve shëndetësore, sipas kërkueses, asaj i është shkaktuar dëm jashtëkontraktor për të cilin është përgjegjës TIA, përgjegjësi të cilën e ka marrë përsipër Sigal sh.a. nëpërmjet kontratës së lidhur mes këtyre shoqërive “Për sigurimin e përgjegjësisë ligjore të kontraktuesve, operatorëve dhe pronarëve të aeroportit”, me afat vlefshmërie deri në datën 23.04.2009. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova. Bazuar në një

analizë të caktuar të provave, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se nuk provohet ekzistenca e elementeve të dëmit jashtëkontraktor, duke arsyetuar se kërkuesja nuk ka provuar faktin e rrëzimit në dyshemenë e aeroportit si rezultat i lagështirës në dysheme dhe dëmtimin e saj shëndetësor nga ky rrëzim, sikundër edhe lidhjen shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të pretenduar. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, nuk vërtetohet ngjarja kontraktore e sigurimit dhe, për pasojë, i padituri nuk legjitimohet pasivisht në lidhje me kërkimin në padi.

20. Në vijim, Kolegji vëren se mbi ankimin e kërkueses, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsytimi. Edhe sipas gjykatës së apelit nuk provohet fakti i rrëzimit të kërkueses në dyshemenë e aeroportit si rrjedhojë e lagështirës në dysheme, si dhe dëmtimi i saj shëndetësor për shkak të rrëzimit. Për sa kohë nuk vërtetohet ngjarja e sigurimit, është shprehur gjykata e apelit, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se i padituri nuk legjitimohet pasivisht në padi. Krahas kësaj, gjykata e apelit ka arsyetuar edhe se kërkuesja (paditësja) nuk legjitimohet në ngritjen e padisë për sa kohë nuk është palë në kontratën e sigurimit.

21. Më tej, Kolegji vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit. Sipas atij kolegji, nuk konstatohen shkelje procedurale që e bëjnë të pavlefshëm procesin dhe ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatave, të cilat, sipas tij, kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë dhe vendimet e dhëna nga ato nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të kolegjit civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, ai kolegji ka sjellë në vëmendje se pjesa e pretendimeve në recurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, ndërsa kontrolli i saj rishikues nuk mund të konsistojë në një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e faktit, pasi një gjë e tillë bie ndesh me vetë natyrën e gjykimit në atë gjykatë.

22. Për sa më sipër, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si dhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se kërkuesja ka ushtruar lirisht të drejtën e ngritjes së padisë, sikurse edhe të drejtën e ankimit dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimin e saj. Vendimi i kundërshtuar i gjykatës së apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ajo, si dhe dispozitat ligjore në të cilat

ajo gjykatë është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykata e apelit ka vlerësuar provat dhe pretendimet e kërkueses në lidhje me ngjarjen e dëmit, të drejtën subjektive të pretenduar nga ajo përkundër detyrimit të të paditurit, por në analizë të provave të administruara në gjykim, si dhe të ligjit të zbatueshëm, ajo gjykatë ka arritur në përfundime jo të njëjta me kërkuesen.

23. Po ashtu, Kolegji vëren se edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuësja është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Ky vendim nuk rezulton të jetë kontradiktor në përmbajtjen e tij.

24. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkueses, që në thelb ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, Kolegji vlerëson se ato nuk janë çështje që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, për sa kohë nga ajo nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit është haptazi i pabazuar. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.